

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 6 (gjashtë) vende pune për personel akademik pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Lektor” në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit.

- ❖ Në programet e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Inxhinieri Elektronike, Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni, Bachelor në Inxhinieri Informatike, Bachelor në Inxhinieri Elektrike (Automatizim, Energjetike, Mekatronike), si dhe në programin e studimit të Ciklit të Dytë, Master Shkencor në Inxhinieri Elektronike:
 - Matje Elektronike (Leksione, seminare, detyra/projekte kursi, laboratore).
 - Elektronikë Fuqie (Leksione, seminare, detyra/projekte kursi, laboratore).
 - Fizika e Materialeve Elektronike (Leksione, seminare, detyra/projekte kursi, laboratore).

Kandidati duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar studimet në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit ose Universitete të huaja, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor+Master Shkencor) në fushën e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinierisë së Telekomunikacionit, ose fusha të ngjashme.
2. Të ketë notë mesatare të ponderuar të studimeve universitare (për sistemet 5-vjeçare), (Bachelor+Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (më e lartë ose e barabartë me 8), dhe nota ≥ 8 në lëndët specifike sipas kërkesës së cituar më sipër.
3. Të zotërojë dëshmi/certifikatë të mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze në nivel akademik C.
4. Preferohet kandidat që ka artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe Kod ISSN si dhe referime shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings, me kod ISBN. Artikujt dhe referimet shkencore do të vlerësohen si të tilla vetëm në rast të lidhjes së tyre me fushën e Inxhinierisë Elektronike, të Telekomunikacionit dhe të Informatikës.
5. Të ketë trajnime të ndryshme në fushën e elektronikës, telekomunikacionit dhe informatikës.
6. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie, të dëshmuar me referenca.
7. Të ketë dy rekomandime, me datë jo më të hershme se data e daljes së njoftimit përkatës të punësimit dhe specifikisht të cilësuar për punësim si pedagog i brendshëm në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit nga stafi akademik i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës, nga departamenti përkatës, ose nga departamenti përkatës (i Fakultetit/Universitetit respektiv) ku kandidati ka kryer studimet, me titull “Profesor” ose “Profesor i asociuar”.
8. Të ketë gradën shkencore “Doktor” dhe/ose titullin akademik “Profesor i asociuar”.

B. 1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Asistent Lektor” në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit.

- ❖ Në programet e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Inxhinieri Elektronike, Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni, Bachelor në Inxhinieri Informatike:
 - Elementet dhe Teknologjitë Elektronike (Ushtrime, detyra kursi, laboratore);
 - Sistemet Elektronike (Ushtrime, detyra kursi, laboratore).

Kandidati duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar studimet në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ose në Universitete të huaja, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor+Master Shkencor) në fushën e Inxhinierisë Elektronike ose Inxhinierisë së Telekomunikacionit, dhe/ose fusha të ngjashme.
2. Të ketë notë mesatare të ponderuar të studimeve universitare (për sistemet 5-vjeçare), (Bachelor+Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (më e lartë ose e barabartë me 8), dhe nota ≥ 8 në lëndët specifike sipas kërkesës së cituar më sipër.
3. Të zotërojë dëshmi/certifikatë të mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze në nivel akademik C.
4. Preferohet kandidat që ka artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe Kod ISSN si dhe referime shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings, me kod ISBN. Artikujt dhe referimet shkencore do të vlerësohen si të tilla vetëm në rast të lidhjes së tyre me fushën e Inxhinierisë Elektronike dhe/ose të Telekomunikacionit si tregues për fushën e ardhshme kërkimore-shkencore të kandidatit.
5. Të ketë trajnime të ndryshme në fushën e elektronikës dhe telekomunikacionit.
6. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie, të dëshmuar me referenca.
7. Të ketë dy rekomandime, me datë jo më të hershme se data e daljes së njoftimit përkatës të punësimit dhe specifikisht të cilësuar për punësim si pedagog i brendshëm në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit nga stafi akademik i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës, nga departamenti përkatës, ose nga departamenti përkatës (i Fakultetit/Universitetit respektiv) ku kandidati ka kryer studimet, me titull “Profesor” ose “Profesor i asociuar”.
8. Të jetë student në shkollën doktrale të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

C. 1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Lektor” në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit.

- ❖ Në programet e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në Inxhinieri Elektronike, Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni, si dhe në programet e Ciklit të Dytë, Master Shkencor në Inxhinieri Telekomunikacioni, Master Shkencor (FIMIF) në Inxhinieri Fizike, Master Profesional (FIMIF) në Inxhinieri Matematike në Analizë Sistemesh:
 - Bazat e telekomunikacionit (Leksione, Seminare, Laboratore);
 - Sistemet e telekomunikacionit (Leksione, Seminare, Laboratore);
 - Sisteme të avancuar të telekomunikacionit (Leksione, Seminare, Laboratore);
 - Teknologjitë e komunikimit (Leksione, Seminare, Laboratore);
 - Teoria e trafikut në rrjetat e telekomunikacionit (Leksione, Seminare, Laboratore).

Kandidati duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar studimet në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ose në Universitete të huaja, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor+Master Shkencor) në fushën e Inxhinierisë Elektronike ose Inxhinierisë së Telekomunikacionit.
2. Të ketë notë mesatare të ponderuar të studimeve universitare (për sistemet 5-vjeçare), (Bachelor+Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (më e lartë ose e barabartë me 8), dhe nota ≥ 8 në lëndët specifike sipas kërkesës së cituar më sipër.
3. Të zotërojë dëshmi/certifikatë të mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze në nivel akademik C.
4. Preferohet kandidat që ka artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe Kod ISSN si dhe referime shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings, me kod ISBN. Artikujt dhe referimet shkencore do të vlerësohen si të tilla vetëm në rast të lidhjes së tyre me fushën e Inxhinierisë Elektronike dhe/ose të Telekomunikacionit si tregues për fushën e ardhshme kërkimore-shkencore të kandidatit.

5. Të ketë trajnime dhe/ose eksperiencë të ndryshme në fushën e elektronikës dhe telekomunikacionit.
6. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie, të dëshmuar me referenca.
7. Të ketë dy rekomandime, me datë jo më të hershme se data e daljes së njoftimit përkatës të punësimit dhe specifikisht të cilësuar për punësim si pedagog i brendshëm në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit nga stafi akademik i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës, nga departamenti përkatës, ose nga departamenti përkatës (i Fakultetit/Universitetit respektiv) ku kandidati ka kryer studimet, me titull “Profesor” ose “Profesor i asociuar”.
8. Të ketë gradën shkencore “Doktor”.

D. 1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Asistent Lektor” në Departamentin e Bazave të Informatikës.

- ❖ Kërkohe të punësohet me kohë të plotë në pozicionin Asistent Lektor që të mbulojë lëndët “Informatika” dhe “Baza e Informatikës”.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë diplomë 3+2 (Bachelor+Master Shkencor) ose 5-vjeçare në fushën e Inxhinierisë Informatike ose profile të ngjashme nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës, ose nga universitete të huaja ose në fushën e Informatikës Ekonomike nga Universiteti i Tiranës.
2. Të ketë notë mesatare të studimeve universitare (Bachelor+Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (më e lartë ose e barabartë me 8).
3. Të ketë mbrojtur doktoraturën në fushën e Inxhinierisë Informatike ose profile të ngjashme, jashtë ose brenda vendit.
4. Preferohet të jetë student doktorature në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit.
5. Të zotërojë dëshmi/çertifikatë të mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet niveli C1 dhe gjuha angleze.
6. Të ketë dy rekomandime nga stafi akademik i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës me titull “Profesor” dhe “Profesor i asociuar”, me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit dhe specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në këtë vend vakant.
7. Preferohet kandidat që ka eksperiencë pune të mëparshme mësimdhënie në universitet (me kohë të plotë ose të pjesshme).
8. Preferohet kandidat që ka artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe Kod ISSN dhe/ose referime shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings, me kod ISBN.

E. 1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Asistent Lektor” në Departamentin e Inxhinierisë Informatike.

- ❖ Kërkohe të punësohet me kohë të plotë në pozicionin Asistent Lektor 1 (një) pedagog që të mbulojë ngarkesën e lëndëve “Bazave të të Dhënave” dhe lëndët e “Programimit” në Bachelor Inxhinieri Informatike.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë diplomë 3+2 (Bachelor+Master Shkencor) ose 5-vjeçare në fushën e Inxhinieri Informatike ose në profile të ngjashme.
2. Të ketë notë mesatare të studimeve universitare (Bachelor+Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 dhe nota 9 ose 10 në lëndët respektive: Bazave të të Dhënave dhe Programimit.
3. Të ketë dy rekomandime nga stafi akademik i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës me titull “Profesor” dhe “Profesor i

asociuar” me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në Departamentin e Inxhinierisë Informatike në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit.

4. Preferohet kandidati të ketë eksperiencë pune të mëparshme mësimdhënie në universitet (me kohë të plotë ose të pjesshme).
5. Preferohet kandidat që ka artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe Kod ISSN si dhe referime shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings, me kod ISBN.

F. 1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Lektor” në Departamentin e Inxhinierisë Informatike.

❖ Kërkohet të punësohet me kohë të plotë në pozicionin Lektor 1 (një) pedagog që të mbulojë lëndët (ose të lidhura me) e mëposhtme, në Ciklin e Dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike:

- “Arkitektura e sistemeve të përpunimit”, Master i Shkencave
- “Arkitekturë e kompjuterave” në Bachelor Inxhinieri Informatike
- “Sistemet Operative” në Bachelor Inxhinieri Informatike

Kandidati duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë diplomë 3+2 (Bachelor+Master Shkencor) ose 5-vjeçare në fushën e Inxhinierisë Informatike ose profile të ngjashme dhe doktoraturë në këtë profil.
2. Të ketë dy rekomandime nga stafi akademik i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës me titull “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në Departamentin e Inxhinierisë Informatike në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit.
3. Të ketë eksperiencë pune të mëparshme mësimdhënie në universitet (me kohë të plotë ose të pjesshme).
4. Të ketë artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe Kod ISSN dhe/ose referime shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings, me kod ISBN.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet (original ose kopje të noterizuar) si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje e gradës shkencore “Doktor”;
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton titujt dhe gradat, trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshmi e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **04.10.2024** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.